

## Mësimet Që La Pas Viti 2008

Nga Neritan Mullaj \*

Ky vit për biznesin në përgjithësi nuk ka qenë i lehtë. Një ekonomi që e gjeti veten përballë ndikimit të një monedhe të gjelbër të zhvlerësuar për një kohë të gjatë, ndërsa mbivlerësimi i Euro-s ngushtoi favorët e integritit ekonomik rajonal dhe europian të vendit.

Gjithsesi vendet e Bashkimit Europian, ku prin Italia me mëse 43%, mbetën partneri kryesor tregëtar i vendit. Sipas Bankës së Shqipërisë, përveç fillimit të vitit dhe një ngritjeje të zbehtë në periudhën e shkurtër të verës (korrik-gusht), në përgjithësi sistemi i shitjeve me pakicë nuk njohu ndonjë rritje të konsiderueshme në volume.

Deficiti i tregtisë së mallrave shënoi vlerën 1.8 miliardë euro, duke qenë rreth 16% më i lartë sesa në vitin 2007. Të ardhurat nga eksporti i mallrave arritën të mbulojnë vetëm 28% të importeve, një raport ky gjithsesi i krahasueshëm me atë të vitit të kaluar.

Transaksionet korente - gjithnjë sipas Bankës së Shqipërisë u rritën përfaqësisht me 10% në raport me një vit më parë, por këtu rolin kryesor e luajti rritja galopante e çmimit të karburanteve për një periudhë mëse gjashtëmujore.

Investimet e huaja direkte neto deri në muajin shtator arritën në 380 milionë euro, më pak se 3% më shumë se një vit më parë.

Vijon ne faqen 2

## BAS në Shqipëri gjatë vitit 2008

**Deri më sot janë:**

**-Ndërmarrë 99 projekte (nga të cilët 75 kanë përfunduar)**

**-Vlerësuar 155 aplikime për projekte**

**-Vizituar mbi 250 klientë potencialë – SME**

**-Identifikuar mbi 70 konsulentë (potencialë), ekspertë dhe kompani konsulence**

**Përgatitja e këtij buletini u mbështet nga Qeveria Portugeze**

## Turizmi Meriton Kujdes - Programi BAS Prezantohet në Shëngjin



Programi BAS, i cili administrohet nga zyra e Programeve TAM/BAS e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), organizoi para disa javësh në Shëngjin, pranë Lezhës, një prezantim me biznesin vendas, anëtarë kryesisht nga sektori turistik por edhe përfaqësues të fushës së ndërtimit, peshkimit, si dhe sipërmarrës nga qyteti i Lezhës. Në takim morën pjesë edhe autoritete vendore dhe drejtori i portit të

Shëngjinit. Takimi synonte të informonte operatorët e biznesit lokal mbi avantazhet që i ofrohen biznesit përmes shërbimeve të programit BAS.

Në hapje të takimit, përfaqësuesi i operatorëve vendas të turizmit Vladimir Prenga falenderoi pjesmarrësit që iu bashkuan këtij prezantimi.

Drejtori kombëtar i Programit BAS, Neritan Vijon ne faqen 3

## Njoftim Shtypi

### Bordi i BERZH Adopton Paketën Anti-Krizë

Londër, Dhjetor 10, 2008/- Bordi i Drejtorëve të BERZH miratoi sot Planin e Biznesit dhe Buxhetin e vitit 2009, i cili i hap rrugën Bankës për të rritur biznesin e saj në vitin 2009 me rreth 20% në përfaqësisht €7 miliard. **vijon në fq. 2**



Gjysma e vlerës shtesë prej €1 miliard në shpenzime ekstra janë parashikuar për Europën Qëndrore dhe Lindore. Rritja e fondeve vjen si përgjigje e BERZH ndaj impaktit të krizës globale financiare në vendet ku Banka operon.

Vijon ne faqen 3


Turizmi, i favorizuar nga zhvillimet infra-strukturore, arriti të prodhonte një hyrje të besueshme financiare për vendin, edhe pse 47% e vizitorëve ishin shqiptarë që riktheheshin në atdhe' për pushime.

Turizmi prodhoi këtë vit mbi 900 milionë euro të ardhura dhe konfirmoi një rritje vjetore prej afro 20%.

Prurjet e emigrantëve arrijnë sivjet në rreth 650 milion Euro, edhe pse deri në shtator ato ishin 13% më të ulta, krahasuar me vitin 2007. Kjo rënie, e cila pritet të thellohet, do të ndikojë padyshim sistemin e tregëtisë me pakicë dhe në përgjithësi sektorin e pasurive të paluajtshme.

Kriza bankare u ndje më tepër në mëndje se në sistemin monetar, duke dëshmuar se Shqipëria po përfitonte nga çfarë konsiderohej si një pikë e dobët e saj.

Qeveria është ambicioze kur thotë se ajo do të ruajë të njëjtën shkallë të rritjes ekonomike, por ky objektivi kërkon më parë një seri masash konkrete, që së pari do të ruanin të lartë gatishmërinë e bankave për të financuar biznesin, dhe nga ana tjetër do të kërkonin një vizion shumë më dinamik nga ana e SME-ve për të diversifikuar në mënyrë më fleksibel dhe efikase në drejtime që mbështesin tregun e brendshëm. Njëkohshëm kjo kërkon edhe një impenjim më të mirë nga konsulenca e specializuar vendase, e cila në këtë moment mund të luajë rol mjaft të rëndësishëm për të garantuar shfrytëzimin sa më të madh dhe eficient të burimeve të brendshme. Më shumë se sot konsulenca profesionale mund të vijon në fq. 4



### Trajnime

\*Me Ndërmarrjet vendase për "Planifikimin e Burimeve të Ndërmarrjeve" Prill-Maj 2008  
 -Morën pjesë 43 përfaqësues nga 34 kompani vendase

\*Me Konsulentët vendas për "Sistemet e Manaxhimit të Sigurisë Ushqimore- ISO 22000:2005" Shtator 2008  
 -Morën pjesë 12 konsulentë

### Takime me Biznesin Vendas

-Workshop me Dhomën Rajonale të Tregëtisë dhe Industrisë në Vlorë. Morën pjesë mëse 20 anëtarë të saj.

I pranishëm Drejtori rajonal i programit BAS Miha Svent dhe Përfaqësuesi i BERZH Sergio Mangjone.

-Workshop me Dhomën Rajonale të Tregëtisë dhe Industrisë në Korçë. Morën pjesë mëse 25 anëtarë të saj dhe përfaqësuesit e programit BAS.

-Workshop me Dhomën Rajonale të Tregëtisë dhe Industrisë në Sarandë. Morën pjesë mëse 18 anëtarë të saj dhe përfaqësuesit e programit BAS.

-Workshop në Shëngjin. Morën pjesë 19 persona.

-Një event ndër-komunikimi dhe promovimi sektorial u mbajt me Dhomën e Tregëtisë dhe Industrisë së Tiranës. Përveç Ministrisë së Ekonomisë dhe përfaqësuesve të lartë të programit BAS dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillimim, në event morën pjesë mëse 100 përfaqësues nga komuniteti i konsulentëve dhe bizneseve lokale.



Programi BAS në Shqipëri ka filluar në qershor të vitit 2006, falë mbështetjes financiare të Qeverisë Hollandeze. Programi ka identifikuar mbi 70 konsulentë, ndërsa mbi 55 prej tyre janë angazhuar direkt në projekte, që variojnë nga studimet e marketingut dhe investimeve deri tek zbatimi i standarteve të cilësisë. Mëse 250 klientë potencialë janë viztuar, kontaktuar nga programi BAS, mbi 130 prej tyre kanë aplikuar pranë zyrës së BAS dhe janë ndërmarrë deri tani gati 100 projekte me kompani specifike (71 nga të cilët kanë përfunduar).



**Mësimet ...** vijon nga faqja 2 asistojë n] ngritjen e strukturave efikase të menaxhimit, uljen e kostove, shmanjen e humbjeve, rritjen e përgjegjësisë ndaj cilësisë dhe shërbimit ndaj klientit, planifikimin real dhe afatgjatë të investimeve, por edhe mundësimin e thithjes së kapitalit të huaj.

E thënë thjesht, përballë një krize globale që mund të njohë përshkallëzime të rëndësishme, por tashmë brenda sistemesh kombëtare – Shqipëria duhet të adresojë më mirë nevojën e saj për zëvendësimin e importeve dhe forcimin e prirjes për eksporte, duke pranuar se këto të fundit mund të zbehen falë tregut të plasarit ndërkombëtar.

Turizmi mund të mos njohë të njëjtën shkallë rritjeje si këtë vit, falë periudhës elektorale, por edhe për shkak të rënies së fuqisë blerëse në mbarë botën. Edhe ata shqiptarë që mundën të vijnë sivjet, ndoshta vitin tjetër do të duhet të kursejnë më tepër.

Përvoja tregon se investimet e huaja që synojnë të hyjnë në Shqipëri po ashtu do të presin fundin e periudhës elektorale për t'u prezantuar apo nisur nga puna. Kështu që burimet e brendshme bëhen jetike në këto kushte për fuqizimin e sistemit ekonomik vendas dhe për gjatëllimin e të gjitha burimeve natyrore dhe njerëzore.

Nevoja për diversifikim që vuan prej disa vitesh kapitali tregëtar është rruga më e shkurtër dhe më e besueshme për aktivizimin më mirë dhe në mënyrë më efikase të burimeve të brendshme. Këtu qeveria mund të marrë një rol të rëndësishëm, nëse vendos të mbështesë jo aq operatorët e veçuar "pionerë" të këtij diversifikimi, por konsorciumet e krijuar nga bashkimi i operatorëve me theks rajonal, të cilët gëzojnë potenciale të verifikueshme asetesh dhe që premtojnë një kthim të shpejtë të investimit. Kjo mund të jetë sidomos e vlefshme për fusha si bujqësia, apo për konsorciume që ndërtojnë një sistem zinxhir prodhimi, duke mbështetur njëri tjetrin në strukturimin e investimeve.

Në këtë drejtim edhe donatorët do të ishin ndoshta më të gatshëm të angazhoheshin, duke zbutur qoftë efektet e pasigurisë që përjetojnë psikologjikisht bankat e vecanta të nivelit të dytë, të cilat nuk kanë asnjë arsye të besueshme që të rrisin nivelin e riskut, ashtu edhe operatorët e sektorit tregëtar.

Në këtë qasje, një rol parësor merr formalizimi i ekonomisë dhe regjistrimi pasuror i aseteve të të gjitha firmave që duan të ruajnë peshën që kanë në treg. Kthimi drejt prodhimit për tregun vendas, zgjerimi i gamës së nënprodukteve të përpunuara, forcimi i tregut vendas dhe

zgjerimi gradual drejt tregjeve rajonale në mbështetje të avantazheve konkurruese vendase, do të ishin një hap i mirë për fillimin e një procesi pilot të diversifikimit, si një përgjigje e parë kombëtare ndaj krizës së përgjithshme botërore.

Po ashtu, në kushtet aktuale, kompanitë private kanë detyrimin të forcojnë tiparet e marketingut, të synojnë më mirë se deri më tani besnikërinë e klientëve dhe të fillojnë procese të mirëfillta të manaxhimit të kujdesit ndaj klientit.

Njëkohshëm ato duhet të rrisin cilësinë e produkteve të tyre dhe të pranojnë një ulje të studiuar të marzhit të fitimit pasi të kenë ngritur sisteme të brendshme të analizës se kostove dhe parametrave kryesore të menaxhimit. Paralelisht do të duhet të punojnë për të zgjeruar klientelën, e cila në kthim do të dijë të shpërblejë operatorët inteligjentë, në momentin e kapërcimit të ngërçit financiar global.

Jo çdo e keqe vjen për të dëmtuar dhe ky është çasti që të "mësojmë" se çfarë duhet të përmirësojmë tek vetja.

Viti 2008 ishte pozitiv për Shqipërinë. Viti 2009 duhet të mbetet po ashtu një vit pozitiv, megjithë luhatjet e pritshme. Nëse i nxjerrim tani mësimet e duhura, do të jemi të kënaqur pas një viti. Sepse 2008 la mjaft mësim nga pas...

\* Neritan Mullaj është Drejtor Kombëtar i Programit BAS në Shqipëri



**Njoftim Shtypi vijon nga fq. 3**

Rritja e parashikuar e fondeve të BERZH në vitin 2009 do të financohet plotësisht nga rezervat e Bankës. Asnjë rritje kapitali apo kontribut shtesë nuk do të kërkohet apo nevojitet nga aksionerët e Bankës. Në të njëjtën kohë, BERZH po punon nga afër me institucione financiare ndërkombëtare të tjera për të ofruar mbështetje dhe për të bashkëpunuar në transaksionet financiare.

**Turizmi Meriton Kujdes** vijon nga fq.3

për mbështetje"- tha në sqarimet e tij Neritan Mullaj.

Duke sjellë përpara të pranishmëve disa histori suksesi, ku kompani të mbështetura nga BAS kanë përfituar edhe pjesmarrjen financiare me investime të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, z.Mullaj ju shpjegoi përmbledhtas të pranishmëve edhe se si BAS mund të ndihmojë kompanitë të përfitojnë nga instrumentat e financimit të BERZH.

"Rruga më e shkurtër për kompanitë që të mund të bindin BERZH për t'u përfshirë në projektet e tyre është nëpërmjet konsulentëve. Dhe BAS është në këtë rast partneri i parë më i përshtatshëm që Ju t'ja arrini kësaj"- tha Mullaj.

Të pranishmit i përshëndeti edhe përfaqësuesi i Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, z.Sergio Mangione. Z.Mangione shpjegoi disa instrumenta të mbështetjes financiare të BERZH.

Sipërmarrësit lezhjanë nënvizuan problemet e hasura më së shumti në praktikën e përditshme të punës, ndërsa thanë se standartizimi i proceseve të manaxhimit dhe zhvillimi i trajnimeve kualifikuese do të ishin me interes të veçantë për ta. Në disa raste ata kërkuan edhe ndihmë për zhvillimin e aktiviteteve në grup, me synim realizimin e një promovioni rajonal më efektiv.

Përfaqësuesit e programit BAS shprehën gatishmërinë të ndihmojnë këtë lloj bashkëpunimi, duke kërkuar si kusht institucionalizimin e këtyre hapave që do të prodhojnë sinergji në sektorë kaq të rëndësishëm, si turizmi.

